

Në bazë të nenit 69 paragrafi 5 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 17.02.2015, miratoi:

PLAN PËR DEDIKIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KAPACITETEVE TË MULTIPLEKSIT DIGJITAL TERESTRIAL TË OPERATORIT TË RRJETIT TË KOMUNIKIMIT PUBLIK ELEKTRONIK QË KA PËR OBLIGIM EMETIMIN E SHËRBIMEVE PROGRAMORE TË RADIODIFUZERËVE

I. LËNDA

Neni 1

Me këtë plan përcaktohet dedikimi dhe shpërndarja e kapaciteteve të multipleksit digjital terestrial të operatorit të rrjetit të komunikimit publik elektronik që ka për obligim emetimin e shërbimeve programore të radiodifuzerëve.

Neni 2

Dedikimi dhe shpërndarja bëhen në pajtim me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Ligjin për komunikime elektronike dhe dispozitat e akteve finale të Konferencës rajonale për radio-komunikime për planifikimin e shërbimeve terestriale radiodifuzive në pjesët e Rajoneve 1 dhe 3, në shtrirjen e frekuencës 174-230 MHz dhe 470–862 MHz (në tekstin e mëtejme RRC-06), si dhe në pajtim me Marrëveshjen rajonale për zbatimin e akteve finale të RRC-06 nga Unioni ndërkombëtar për telekomunikime (ITU).

II. DEFINICIONE

Neni 3

Shprehje të caktuara, të përdorura në këtë Plan kanë këtë domethënie:

1. **Zona e shtrirjes** (*Alltoment zone*) është rajoni gjeografi i definuar me pika gjeografike, respektivisht pika që paraqesin kufijtë e zonës. Në zonën e shtrirjes zbatohet planifikimi sipas parimit të ndarjes së frekuencave në kufijtë e zonës. Frekuencat e ndara janë në pajtim me RRC 06.
2. **Veprimtaria radiodifuzive në nivel rajonal** është veprimtaria radiodifuzive që e kryen radiodifuzeri që siguron shikueshmëri nga së paku 80% nga popullata e rajonit të zonës së shtrirjes.
3. **Multipleksi digjital terestrial** (*MUX*) është një rrjedhë e standardizuar e një sërë sinjaleve që përmbajnë shërbimet radio televizive programore, shërbime shtesë dhe informata dhe të dhëna përcjellëse dhe i cili emetohet deri te përdoruesit përmes një kanali terestrial radiofrekuentues.
4. **Sistemi digjital terestrial** është rrjeti i komunikimit elektronik i cili përmbajtjen e multipleksit digjital terestrial e emeton deri te përdoruesit përmes radiokomunikimit terestrial.

5. **Emetimi i lirë** (*Free-to-air*) është emetimi i pa koduar i shërbimeve radio televizive të dedikuara për publikun.
6. **EPG** (Electronic program guide) – Udhëzuesi elektronik për programe është funksioni që mundëson informatë për orarin e përmbajtjeve të shërbimeve televizive dhe qasje së drejtpërdrejtë te përmbajtjet.
7. **MPEG** – (Moving Picture Expert Group) – Standardet për kompresimin e videos digjitale.
8. **SD** – (Standard Definition) – Definicioni standard i fotografisë.
9. **HD** – (High Definition) - Definicion i lartë i fotografisë.
10. **DVB-T** - (*Digital Video Broadcasting Terrestrial*) - Radiodifuzion digjital terestrial .
11. **API** – () Interfejs programor aplikativ (API) është interfejs softuerik në mes aplikacioneve që i ofrojnë radiodifuzerë ose ofruesit e shërbimeve dhe mjeteve të pajisjes bashkëkohore të televizionit digjital për shërbime të televizionit digjital dhe të radios.

III. DEDIKIMI I MULTIPLEKSEVE DIGJITALE TERESTRIALE

Neni 4

Për emetimin digjital të shërbimeve programore radiotevizive janë të dedikuar katër (4) multipleks.

Multipleksët MUX4 dhe MUX5 janë të dhënë për përdorim te NP Radiodifuzioni i Maqedonisë, ndërsa janë të dedikuar për emetim digjital të Shërbimeve publike programore të NP Radiotevizioni i Maqedonisë.

Multipleksët MUX6 dhe MUX7 janë të dedikuar për emetim të lirë (free-to-air) të shërbimeve radiotevizive të shoqërive tregtare radiodifuzive që kanë marrë leje për emetim radioteviziv nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, për dëgjueshmëri, respektivisht shikueshmëri në nivel shtetëror dhe rajonal.

IV. Shpërndarja e kapaciteteve emetuese të multipleksit digjital terestrial.

Neni 5

NP Radiodifuzioni i Maqedonisë për multiplekset MUX4 dhe MUX5 si dhe operatori i rrjetit të komunikimit publik për multipleksët MUX6 dhe MUX7 janë të obliguar që të plotësojnë karakteristikat teknike të DVB-T rrjetit (EN 300 744) dhe të sigurojnë mbulim me sinjal për së paku 80% të popullsisë së Republikës së Maqedonisë, respektivisht të popullsisë nga rajoni përkatës.

Kapaciteti minimal emetues i multipleksëve MUX4, MUX5, MUX6 и MUX7 është 22 Mbs, për çdo multipleks në veçanti.

Neni 6

Kapacitetet emetuese të multipleksëve MUX4, MUX5, MUX6 и MUX7 duhet të sigurojnë emetim të shërbimeve televizive programore në definicion standard (SDTV) dhe në definicion të lartë (HDTV) me standardin për kodim audio dhe video (kodim të fotografisë dhe tonit) ITU-T H.264 | ISO/IEC 14469 ose MPEG 4 AVC).

Neni 7

Për përmbajtjet e shërbimeve televizive në definicion standard (SDTV) rrjedha e nevojshme e të dhënave është prej 1,5 - 2,5 Mbps, përfshirë edhe emetimin e shërbimeve shtesë.

Për përmbajtjet e shërbimeve televizive në definicion të lartë (HDTV) rrjedha e nevojshme e të dhënave është prej 4 - 8 Mbps, përfshirë edhe emetimin e shërbimeve shtesë.

Parametrat teknik për përmbajtje audiovizuale me definicion standard (SD) dhe me definicion të lartë (HD) janë të pasqyruara në Shtesën 1.

Neni 8

Operatorët e multipleksëve digjitale janë të obliguar që të sigurojnë udhëzues elektronik për programet (EPG) për çdo shërbim programor televiziv në bazë të të dhënave të fituara nga ana e radiodifuzerëve.

Neni 9

Operatorët e multipleksëve digjitale sigurojnë emetim të këtyre shërbimeve shtesë:

- titrimi në më shumë gjuhë, të siguruara nga shoqëritë tregtare radiodifuzive;
- ton me më shumë kanale, të siguar nga shoqëritë tregtare radiodifuzive;
- Teletekst, të siguar nga shoqëritë tregtare radiodifuzive;
- API e hapur

Neni 10

Kapaciteti i një MUX të vetëm (prej së paku 22 Mbps) është i mjaftueshëm për emetimin e dhjetë (10) shërbimeve programore televizive me definicion standard ose tre (3) shërbime të programit televiziv me definicion të lartë.

Neni 11

Orarin i shërbimeve të programeve televizive të radiodifuzorëve në udhëzuesin elektronik për programin (EPG) për MUX6 dhe MUX7 e përcakton Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale një herë në vit, sipas emetimit të tyre (shtetëror ose rajonal) dhe të dhënat për ndikimin në shikueshmëri. Të parët do të jenë shërbime programore të servisit publik radiodifuziv "Radio – televizioni i Maqedonisë" e më pas shërbimet programore të shoqërive tregtare të radiodifuzionit në nivel shtetëror, që emetohen përmes kapacitetin transmetues të multipleksit digjital terestrial, e më pas shërbimet programore të shoqërive tregtare radiodifuzive në nivel rajonal, që emetohen përmes kapaciteti transmetues të multipleksit digjital terestrial, sipas të dhënave zyrtare për shikueshmërinë nga viti i kaluar.

Neni 12

Në pajtim me ligjin për shërbime mediatike audio dhe addiovizuale, rajonet e emetimit në nivel rajonal konsiderohen zonat e përhapjes të përcaktuara në RRC-06 përveç në zonën në zonën e përhapjes D1- Maja e zezë për multiplekset MUX6 dhe MUX7. Për multiplekset MUX6 dhe MUX7 zona e përhapjes D1 - Maja e Zezë është ndarë në dy rajone të emetimit edhe atë Shkup dhe Veles, respektivisht rajoni i nivelit rajonal Shkup dhe rajonin e nivelit rajonal Veles. Rajoni i emetimit të nivelit rajonal Shkup i përmban qytetin Shkup dhe Komunat Çuçer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopištë. Rajoni i emetimit në nivel rajonal Veles i përmban komunat Veles, Çashkë, Sveti Nikollë, Llozovë, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe një pjesë të komunës së Kavadarit.

Në Shtesën 2 janë të dhënë rajonet e emetimit në nivel rajonal.

Në Shtesën 3 është dhënë shpërndarja e multiplekseve në rajonet e emetimit.

Neni 13

Shërbimet e programeve publike të NP Radiotelevizioni i Maqedonisë dhe të shërbimeve programore të shoqërive tregtare të radiodifuzionit që emetojnë program në nivel shtetëror, emetohen në të gjitha zonat e përhapjes.

Shërbimet programore të shoqërive tregtare të radiodifuzionit që emetojnë program në nivel rajonal emetohen në rajonin e emetimit për të cilin kanë marrë leje për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Plani pushon vlefshmëria e Planit për dedikimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve emetuese të multipleksit digjital terestrial. ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 168/12 dhe 73/13).

Neni 15

Ky plan hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit të tij në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Nr. 01-1268/1

Shkup


**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuele
Kryetar i Këshillit të Agjencisë,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Shtesa 1. Parametrat teknik për përmbajtjet audiovizuale me definicion standard (SD) dhe me definicion të lartë (HD):

	SD	HD (1080)
Shpejtësia e kornizës së videos		25 Hz p (progressive) /50 Hz i (interlaced)
Formati i fotografisë	4:3 или 16:9	16:9
Rezolucioni	720 x 576	1280 x 720 /1920 x 1080
Audiofrekuenca e semplitimit	48 kHz	48 kHz
Rrjedha e të dhënave	1,5 – 2,5 Mbps	4 – 8 Mbps

Shtesa 2. Rajonet e emetimit



Shtesa 3. PËRHAPJA E MULTIPLEKSËVE NË RAJONET E EMETIMIT

		NP Radiodifuzioni i Maqedonisë		OPERATORI I RRJETIT PUBLIK TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK	
Shenja	Emri i zonës (rajonit)	MUX 4	MUX 5	MUX 6	MUX 7
D1	Maja e Zezë / Shkup	23	52	33	45
D1	Maja e Zezë/ Veles	23	52	40	47
D2	Stracin	37	42	50	56
D3	Turtel	24	39	38	55
D4	Boskija	34	41	57	54
D5	Pelister	22	37	38	42
D6	Mali Vlaj	26	36	44	50
D7	Stogovo	28	43	35	31
D8	Kodra e Diellit	27	36	41	50

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele